



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE

**PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT “SHERBIME PER
RIPARIMIN DHE MIREMBAJTJEN E SISTEMEVE TE FURNIZIMIT ME UJE TE
PIJSHEM DHE IMPJANTEVE HIDRIKË PER SHUARJEN E ZJARRIT”**

I mbajtur sot në datë 19.02.2026 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **“Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e sistemeve te furnizimit me uje te pijshem dhe impjanteve hidrikë per shuarjen e zjarrit”**, me fondin limit **32 799 990** (tridhjetë e dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) **Lekë pa Tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Për arsye organizative dhe llojit te shërbimit te kerkuar, levrimi i ketij shërbimi te vecante me disa operatore nuk eshte i favorshem dhe krijon veshtiresi për Autoritetit Kontraktor .

Nisur nga kompleksiteti i shërbimeve specifike që nevojten për mbarëvajtjen e pajisjeve të rrjeteve/sistemeve teknike për furnizimin me ujë dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit duhet të ndiqen në vazhdimësi dhe kohë reale për mundësimin e kushteve optimale dhe teknike të tyre është e nevojshme që shërbimet të kryhen nga një operator ekonomik i vetëm me specialistët e tij përkatës.

Ndryshimi i personelit të specializuar për ndërhyrjet e nevojshme në riparim-shërbimet që do të realizojnë objektin e kontratës gjatë zhvillimit të saj do të sillte problematika në funksionimin dhe linjën e shërbimeve duke e bërë të pamundur hapjen e konkurrencës e cila do të sillte vonesa kohore. (psh. defekti i pompës/grup pompave të furnizimit me ujë apo panelit të komandimit si dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit në një objekt nuk premtan kohë të hapet procedure minikonkurrence).

Gjithashtu rëndësi të veçantë ka dhe lloji i materialeve që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës, pjesë e cila është ngushtësisht e lidhur me natyrën e shërbim-riparimeve për të cilat do të përdoren. Përgjithësisht nga natyra e shërbim-riparimeve që mbulon autoriteti kontraktor sipas fushës së veprimtarisë do të përdoren mallra të ndryshme për kryerjen e së njëjtës punë

dhe duhet patjetër që këto mallra të përkojnë me standartet teknike të njëra-tjetrës pasi në Dokumentata Standarte të Tenderit, specifikimet teknike janë përcaktuar me diapazon brenda limiteve maksimale dhe minimale (sipas përcaktimeve ligjore dhe rekomandimeve të app) dhe mundësia që ato nuk janë të njëjta nga ofertues të ndryshëm është shumë e madhe (psh. nuk mund të përkojnë pjesët e ndërrimit të një marke prodhimi me të një tjetre, ndërsa OE që ka lidhur MK merr masa paraprake për krijimin e fondit rezervë të pjesëve të ndërrimit, etj.) për këto shkaqe të parashtruara më sipër MK duhet të lidhet me një operator ekonomik.

PËR NJËSINË E PROKURIMIT:

1. Marisa Kaçori _____
2. Ornela Telo _____
3. Julian Malka _____